

## MARREVESHJE KONTRIBUTI

Kjo MARREVESHJE KONTRIBUTI ("Marrëveshja"), e datës 4 qershor 2020 është nënshkruar ndërmjet Andi Ballta, një individ ("**Kontribuesi**"), dhe Moscopole Inc., një korporatë në Delaware ("**Perfituesi i Kontributit/ Perfituesi**").

### DEKLARIME TE PALEVE

**DUKE QENE SE**, Kontribuesi zotëron të gjitha titujt e emetuar të Përfituesit;

**DUKE QENE SE**, NCH Balkan Fund, LP, një partneritet i kufizuar i përjashtuar i regjistruar në Ishujt Kajman dhe New Century Holdings XI, LP, një partneritet i kufizuar i përjashtuar i regjistruar në Ishujt Kajman, secili ka shqyrtuar transaksionin e parashikuar nga kjo Marrëveshje dhe kanë autorizuar dhe aprovuar rregullisht kete transaksion;

**DUKE QENE SE**, Kontribuesi (a) zotëron një kuotë që korrespondon me 30% të kapitalit me një vlerë nominale 53,187,472 Leke shqiptare me vlerë ekuivalente në Dollare amerikane 479,944.70 USD ("**Kuota e Zotuar te Tranzit**") (KZT) të Tranzit sh.p.k, një shoqëri shqiptare me përgjegjësi të kufizuar ("**Tranzit**") dhe (b) çdo të drejtë përfitimi pronësore siç përshkruhet në Marrëveshjen Kuadër, datë 11 Dhjetor 2019, e ndryshuar ("**Kuota e Perfituar te Tranzit**") (KPT), së bashku me Kuoten e Zotuar te Tranzit, "**Kuota e Tranzit e Kontribuar**") (KTK); dhe

**DUKE QENE SE**, Kontribuesi dëshiron të kontribuojë KTK te Perfituesi dhe Perfituesi dëshiron të pranojë kontributin nga Kontribuesi, në termat dhe kushtet e përcaktuara më poshtë.

**ATEHERE**, duke marrë parasysh kushtet dhe përfaqësimet, garancitë dhe marrëveshjet e përcaktuara më poshtë, palët këtu, duke pranuar të jenë të detyruara ligjërisht, do të bien dakord si më poshtë:

1. Kontributi. Duke filluar nga data e këtij dokumenti, Kontribuesi këtu kontribuon (a) të drejtën, titullin dhe interesin të KZT dhe (b) KPT për vlerën e përcaktuar në Seksionin 2 më poshtë. Perfituesi pranon këtu kontributin e KTK. Vlera e interesit të kontribuar është e barabartë me vlerën nominale të sipërpërmendur të kuotës në pronësi të Tranzit.
2. Vlera. Sa i përket vlerës së kontributit të përcaktuar në Seksionin 1, Perfituesi pranon të emetojë 1000 aksione të stokut të zakonshëm të vet për Kontribuesin ("**Stoku i Zakonshëm i Kontributit**").
3. Përfaqësimet dhe Garancitë e Kontribuesit. Kontribuesi përfaqëson dhe garanton Përfituesin si më poshtë:
  - (a) Kompetencat. Kontribuesi ka të drejta të plota, kompetenca, autoritet dhe aftësi, sipas rastit, të ekzekutojë këtë Marrëveshje dhe të përmbushë detyrimet e tij më poshtë në përputhje me kushtet e saj. Kontribuesi ka ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për ekzekutimin, dorëzimin dhe kryerjen e kësaj Marrëveshjeje, dhe kjo Marrëveshje përbën detyrimin ligjor, të vlefshëm dhe detyrues të Kontribuesit, të zbatueshëm në përputhje me kushtet e saj.

(b) Pronësia. Kontribuesi (i) ka pronësi përfituese të KPT dhe (ii) ka një titull të paster dhe të tregtueshëm, në të gjitha aspektet materiale, të KZT, të lire e të pastër nga të gjitha borxhet, hipotekat, pengjet, premtimet, pengesat, detyrimet, etj. interesat në tituj ose kufizime të tjera në transferimin ose të drejtat e pronësisë në ato interesa.

#### 4. Kontributi për investime.

(i) Kontribuesi e kupton që Stoku i Zakonshem i Kontributit nuk është regjistruar në bazë të Ligjit Federal për Titujt, apo të ligjeve të zbatueshme të shteteve për titujt ("Ligjet Blu Sky"), duke u mbështetur në përjashtimet e parashikuara në Ligjin Federal për Titujt, Ligjet Blue Sky, apo çdo rregullore e zbatueshme ose interpretime të tyre, dhe nuk mund të ofrohet për shitje, shitet ose transferohet në ndonjë mënyrë, përveç, kur ndërmjet të tjerash, Stoku i Zakonshem i Kontributit regjistrohet më pas ose kualifikohet për përjashtim nga regjistrimi në bazë të Ligjit Federal për Titujt dhe Ligjet Blue Sky. Kontribuesi pranon se është në gjendje të përballojë rrezikun ekonomik të investimit në Stokun e Zakonshem të Kontributit për një periudhë të pacaktuar kohe.

(ii) Kontribuesi po merr Stokun e Zakonshem i Kontributit në mirëbesim vetëm për llogari të tij, për investime dhe jo me qëllim të rishitjes ose shpërndarjeje tjetër në kundërshtim me Ligjin Federal për Titujt, Ligjet Blue Sky, ose ligj tjetër të zbatueshëm.

(iii) Kontribuesi është një "investitor i akredituar" në kuptim të Rregullores D në bazë të Ligjit Federal për Titujt.

(a) Nuk ka konflikt me marrëveshje të tjera. Kontribuesi nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim që përbën konflikt ose shkelje, e edhe ekzekutimi e dorëzimi i kësaj marrëveshjeje e të tjerave të parashikuara këtu nuk shkakton konflikt ose shkelje, të ndonjë marrëveshjeje moskonkurrence, mosndërrhyrje, ose konfidencialiteti ku Kontribuesi është palë ose sipas të cilës ka detyrime, e Kontribuesi as nuk ka hyrë në ndonjë kontratë, ndërmarrje, marrëveshjeje me ndonjë person për të shitur, transferuar ose dhënë një pjesëmarrje për një person të tillë në lidhje me shitjen, transferimin, votimin ose të drejta të tjera të stokut të zakonshem të Perfituesit.

#### 5. Përfaqësimet dhe Garancitë e Perfituesit. Perfituesi këtu përfaqëson dhe i garanton Kontribuesit që:

(a) Organizimi. Perfituesi është një korporatë e organizuar rregullisht, që ekziston në mënyrë të vlefshme dhe në gjendje të mirë sipas ligjeve të Delaware.

(b) Kompetencat. Perfituesi ka të drejta të plota, kompetenca, autoritet dhe aftësi, sipas rastit, të ekzekutojë këtë Marrëveshje dhe të përmbushë detyrimet e tij më poshtë në përputhje me kushtet e saj. Perfituesi ka ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për ekzekutimin, dorëzimin dhe kryerjen e kësaj Marrëveshjeje, dhe kjo Marrëveshjeje përbën detyrimin ligjor, të vlefshëm dhe detyrues të Perfituesit, të zbatueshëm në përputhje me kushtet e saj.

#### (c) Kontributi për investime.

(i) Perfituesi e kupton që KTK nuk është regjistruar në bazë të Ligjit Federal për Titujt, apo të ligjeve të zbatueshme të shteteve për titujt ("Ligjet Blu Sky"), duke u mbështetur në përjashtimet e parashikuara në Ligjin Federal për Titujt, Ligjet Blue Sky, apo çdo rregullore e zbatueshme ose interpretime të tyre, dhe nuk mund të ofrohet për shitje, shitet

ose transferohet ne ndonjë menyre, përveç, kur ndermjet të tjerash, KTK regjistrohet më pas ose kualifikohet për përjashtim nga regjistrimi në bazë të Ligjit Federal për Titujt dhe Ligjet Blue Sky. Perfituesi pranon se është në gjendje të përballojë rrezikun ekonomik të investimit në KTK për një periudhë të pacaktuar kohe.

(ii) Perfituesi po merr KTK në mirëbesim vetëm për llogari të tij, për investime dhe jo me qëllim të rishitjes ose shpërndarjeje tjetër në kundërshtim me Ligjin Federal për Titujt, Ligjet Blue Sky, ose ligj tjetër të zbatueshëm.

(iii) Perfituesi është një "investitor i akredituar" në kuptimin e Rregullores D sipas Ligjit Federal për Titujt.

6. Deklarime. Në lidhje me kontributin e Kontribuesit të KTK, dhe lëshimin nga Perfituesi të Stokut të Zakonshëm të Kontributit në përputhje me termat dhe kushtet e kësaj marrëveshje:

(a) Kontribuesi pranon, deklaron dhe bie dakord si më poshtë:

(i) Të gjitha të drejtat dhe detyrimet e Kontribuesit në lidhje me Stokun e Zakonshëm të Kontributit përfshirë edhe të drejtat e votimit dhe transferimit, do të përcaktohen me ligj ose në certifikatën e themelimit të Perfituesit.

(ii) Kontribuesi pranon që të mos transferojë ose të disponojë Stokun e Zakonshëm të Kontributit në kundërshtim me certifikatën e themelimit të Perfituesit, statutin, Ligjin Federal të Titujve, Ligjet Blue Sky, ose ndonjë tjetër ligj të zbatueshëm.

(iii) Kontribuesi pranon se nuk mbështetet te asnjë person, firmë apo korporatë, përveç Perfituesit, në vendimmarrjen për të investuar dhe për të bërë investimet e tij tek Perfituesi.

(iv) Stoku i Zakonshëm i Kontributit nuk është i regjistruar në bazë të ligjeve të titujve federale ose shtetërore. Nuk ka asnjë treg publik ose tjetër treg për Stokun e Zakonshëm të Kontributit dhe as ka të ngjarë të zhvillohet.

(v) Kontribuesi nuk ka marrë persiper dhe nuk është bërë përgjegjës për tarifën e ndonjë komisioni ose tarife brokeri në lidhje me transaksionet e parashikuara nga kjo marrëveshje.

(vi) Kontribuesi pranon që Perfituesi është formuar rishtazi dhe nuk ka kryer ndonjë biznes tregtar, dhe as nuk ka lidhur ndonjë kontratë që sjell të ardhura me ndonjë person tjetër, përveç sa i përket (i) krijimit dhe operacioneve të tij të fillimit, dhe (ii) ofrimit të stokut të zakonshëm.

(vii) Kontribuesi pranon se certifikata që përfaqëson Stokun e Zakonshëm të Kontributit duhet të përmbajë në thelb legjendën e mëposhtme:

AKSIONET E PERQESUARA NGA KJO CERTIFIKATE NUK JANE REGJISTRUAR SIPAS LIGJIT TE TITUJVE TE VITIT 1933, I NDRYSHUAR ("LIGJI I TITUJVE"), OSE LIGJEVE TE SHTETEVE PER TITUJT DHE NUK MUND TE OFROHEN, SHITEN OSE TRANSFEROHEN NE MUNGESË TE REGJISTRIMIT OSE TE PERJASHTIMIT NGA REGJISTRIMI SIPAS LIGJIT PER TITUJT APO LIGJEVE TE SHTETEVE PER TITUJT DHE RREGULLOREVE TE DALA PER TO. AKSIONET TE PERFAQESUARA NGA KJO CERTIFIKATE JANE PERFITUAR NGA PRONARI I REGJISTRUAR KETU PER INVESTIME DHE JO ME QELLIM PER T'I SHITUR NE LIDHJE ME NDONJE SHPERNDARJE NE SHKELJE TE LIGJIT PER TITUJT. AKSIONET NUK MUND TE SHITEN, TE LIHEN PENG, TE TRANSFEROHEN OSE TE KALOHEEN PERVEC NE NJE TRASAKSION QE ESHTË I PERJASHTUAR SIPAS

DISPOZITAVE LIGJIT PER TITUJT APO LIGJEVE TE SHTETEVE PER TITUJT LETRAVE ME VLERE, OSE TE LIGJEVE NE FUQI TE SHTETIT, OSE NE ZBATIM TE NDONJE DEKLARIMI REGJISTRIMI EFEKTIV OSE NE NJE TRANSAKSION QE ESHTË NE PERPUTHJE ME LIGJIN E TITUJVE OSE LIGJET E SHTETEVE PER TITUJT.

(b) Përfituesi pranon, njeh dhe bie dakord si më poshtë:

(i) Të gjitha të drejtat dhe detyrimet e Përfituesit në lidhje me KTK, përfshirë të drejtat e votimit dhe transferimit, do të jene sic përcaktohen me ligj ose në certifikatën e themelimit të Tranzit (statut).

(ii) Përfituesi ketu pranon që të mos transferojë ose të disponojë KTK në kundërshtim me statutin e Tranzit, Ligjin Federal të Titujve, Ligjet Blue Sky, ose ndonjë tjetër ligj të zbatueshem.

(iii) Përfituesi pranon se nuk mbështetet te asnjë person, firmë apo korporatë, përveç Kontribuesit, në vendimmarrjen për të investuar dhe për të bërë investimet e tij në Tranzit.

(iv) KTK nuk është regjistruar në bazë të ligjeve federale ose të letrave me vlerë shtetërore. Nuk ka asnjë treg publik ose tjetër për KTK dhe as ka të ngjarë të zhvillohet.

(v) Përfituesi nuk ka pësuar dhe nuk është bërë përgjegjës për tarifën e ndonjë komisioni ose brokeri në lidhje me transaksionet e parashikuara nga kjo Marrëveshje.

7. Te ndryshme.

(a) Marrëveshja e detyrueshme; Pasardhësit dhe Kalimet. Kjo Marrëveshje do të jetë detyruese dhe në dobi të palëve këtu, dhe pasardhësve dhe atyre që u kalohet. Asnjë nga palët nuk mund të kalojë ndonjë prej të drejtave të saj ose të delegojë ndonjë nga detyrat e saj sipas kësaj Marrëveshjeje pa pëlqimin paraprak me shkrim të tjetrit.

(b) Asnjë Palë e Tretë Përfituese. Asgjë në këtë Marrëveshje, qoftë e shprehur apo e nënkuptuar, nuk ka për qëllim të japë të drejta ose mjete juridike, ose për shkak të kësaj Marrëveshjeje, për cilindo person ose entitet tjetër përveç palëve këtu dhe drejtuesit e tyre, administratorët, përfaqësuesit personal, pasardhësit dhe kalimet e lejuara.

(c) Ndryshimi. Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet vetëm me një instrument me shkrim të ekzekutuar nga palët, dhe plotësohet vetëm nga dokumentet e dorëzuara ose që duhet të dorëzohen në përputhje me kushtet e tij.

(d) Kopjet e Kontrates. Kjo Marrëveshje mund të ekzekutohet në dy ose më shumë kopje, secila prej të cilave do të konsiderohet një origjinal dhe të gjitha së bashku do të përbëjnë, një dhe të njëjtin dokument. Një nënshkrim i dërguar me email të një dokumenti PDF konsiderohet këtu se është nënshkrimi origjinal dhe një dorëzim i tillë do të konsiderohet se ka të njëjtin efekt juridik si dërgimi i një kopjeje të nënshkruar origjinale të kësaj Marrëveshjeje.

(e) Garantimet e mëtejshme. Secila nga palët duhet të ekzekutojë dhe dorëzojë dokumente dhe instrumente të tilla dhe të ndërmarrë veprime të tilla të mëtejshme që mund të

kërkohen në mënyrë të arsyeshme për të realizuar dispozitat dhe transaksionet e parashikuara këtu.

(f) Titujt. Titujt në këtë Marrëveshje janë vetëm për qëllime referimi dhe nuk synojnë të jenë pjesë ose të ndikojnë në kuptimin ose interpretimin e kësaj Marrëveshjeje.

(g) Ligji drejtues. Kjo Marrëveshje do të qeveriset dhe interpretohet në përputhje me ligjet e brendshme të Shtetit të Delaware, dhe të USA.

(h) Kohezgjatja. Të gjitha përfaqësimet, garancitë dhe deklaratimet e përmbajtura këtu do të mbijetojnë në ekzekutimin, dorëzimin dhe performancën e kësaj Marrëveshjeje.

(i) Ndashmeria. Cdo dispozitë ose term i kësaj Marrëveshjeje e cila është e pavlefshme, e paligjshme ose e pazbatueshme në çdo juridiksion, për juridiksionin e tillë, do të jetë joefektive vetëm në masën e pavlefshmërisë, paligjshmërisë ose pazbatueshmërisë së tillë pa prekur vlefshmerinë e dispozitave të mbetura të tij ose pa ndikuar në vlefshmërinë, ligjshmërinë ose zbatueshmëria e një dispozite të tillë në çdo juridiksion tjetër.

*Vijon faqja e nenshkrimit*



NE PRANI TE SA ME POSHTE, palet ne kete marreveshje kane ekzekutuar kete Marreveshje sipas dates me siper.

**KONTRIBUESI:**

**Andi Ballta**  
(firma)

  
\_\_\_\_\_

**PERFITUESI:**

**Moscopole Inc.**  
(firma)

emri: Andi Ballta  
titulli: Kryetar i Bordit

  
\_\_\_\_\_